



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2022:201522

Datë: 10.12.2024

Numri i dokumentit: 06572568

C.nr.601/2022

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Avni Berisha, me bashkëpunëtoren profesionale Shpresa Haxhijaha Rahmani, në çështjen juridiko-civile të paditësit B.K nga fshati Bellacërkë, Komuna e Rahovecit, të cilin me autorizim e përfaqëson Avokat D.M nga Prizreni, kundër të paditurës S me seli në Prishtinë, lidhur me çështjen kontestimore padi për Kompensim dëmi, vlera e kontestit 1,500.00 euro, më datë 10.12.2024 mori këtë:

A K T V E N D I M

KONSIDEROHET SË ËSHTË TËRHEQUR padia e paditësit B.K nga fshati Bellacërkë, Komuna e Rahovecit, kundër të paditurës S me seli në Prishtinë, lidhur me çështjen kontestimore padi për Kompensim dëmi, vlera e kontestit 1,500.00 euro.

Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi B.K nga fshati Bellacërkë, Komuna e Rahovecit, përmes përfaqësuesit të tij të autorizuar, me datë 29.09.2022 ka paraqitur në Gjykatë padi për Kompensim dëmi.

Gjykata duke vepruar lidhur me këtë çështje, ka marrë Aktvendim C.nr.601/2022, i datës 05.12.2022, me të cilin e ka ftuar paditësin B.K nga fshati Bellacërkë, Komuna e Rahovecit, që në afatin prej 15 ditëve të paguaj taksën gjyqësore në shumën prej 40 (katërdhjetë) euro.

Në shkresat e lëndës deri më tani gjykata nuk pranuar ndonjë shkresë nga pala paditëse pagesën e taksës.

Duke marrë parasysh faktin se as pas aktvendimit të ndërmarrë nga gjykata, paditësi nuk bërë pagesën e taksës, gjykata vendosi si në dispozitiv, e në pajtim me dispozitat e nenit 253 pika 4. Dhe 5. të Ligjit nr.03/1-006 për Procedurën Kontestimore, në të cilin nen thuhet se: “ 253.4 Paditësi ka për detyrë që padisë t’ia bashkangjis vërtetimin mbi taksën gjyqësore të paguar. 51 253.5 Në qoftë se paditësi nuk e paguan taksën gjyqësore të përcaktuar për padinë as pas vërejtjes së dërguar nga gjykata, edhe pse nuk ekzistojnë konditat për lirim nga detyrimi i pagimit të taksës gjyqësore, do të konsiderohet se padia është tërhequr.”

Vendimi mbi shpenzimet procedurale, që secila palë t'i bartë këto shpenzime, është marrë në kuptim të nenit 450 të LPK-së.

Prandaj, nga ajo që u tha më lartë, kjo gjykatë vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, e në bazë të nenit 253 pika 4 dhe 5 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC  
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil  
C.nr.601/2022, më datën 10.12.2024

Gjyqtari  
Avni Berisha

**KËSHILLË JURDIKE:** Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit.